



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Data: 05.10.2017

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës , në mbështetje në neni 28 (1.2), neni 29, paragrafi (1) , neni 54 paragrafi (1.9), neni 3 paragrafi (1.8), neni 35 paragrafi (5) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 03/L-229 datë 07 Tetor 2010, (Gazeta Zyrtare nr.88/25 nëntor 2010), Neni 32 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L -031, (Gazeta Zyrtare/ Nr. 20 /2016 / 21.06.2016). AKK ka pranuar një kërkesë nga Fondi i Kursimeve Pensionale “ TRUSTI” me seli ne Prishtinë, me nr. prot. 2014/1903 dt. 27.10.2014. Kërkesa e “TRUSTI”-t ka të bëjë me fillimin e procedurës ndaj operatorëve ekonomik K.S “Vienna Insurance Group” dhe K.S “Siguria”. Dyshimet e Trustit bazohen se me veprimin e tyre këto kompani sigurimi kanë bërë marrëveshje të ndaluar me rastin e dorëzimit të ofertave në prokurimin publik me aktivitetin tek “Shërbimet e sigurimit fiduciar” . Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me datë **05.10.2017**, mori këtë:

KONKLuzion

- 1. Vlerësojmë se kërkesa e dorëzuar pranë Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ka pushuar te shqyrtohet pasi që, pëlqimi apo miratimi është dhënë nga OSHP dhe është në favor të palës;**
- 2. Autoriteti vlerëson se lënda me nr. të protokollit : 2014/1903 ,me datë 27.10.2014, merr epilogun sikur në pikën 1 të këtij diapozitivi;**
- 3. Rasti konsiderohet i mbyllur;**

ARSYETIM

Me datë 27.10.2014 Fondi i kursimeve pensional “TRUSTI” me seli ne Prishtinë ka adresuar kërkesën me numër protokollit 2014/1903 pranë AKK-së.

Kërkesa e TRUSTIT ka të bëjë me fillimin e procedurës ndaj operatorëve ekonomik K.S “Vienna Insurance Group” dhe K.S “Siguria”.

Dyshimet e Trustit bazohen se me veprimin e tyre këto kompani sigurimi kanë bërë marrëveshje të ndaluar lidhur me rastin e dorëzimit të ofertave në prokurimin publik me aktivitetin “ Shërbimet e sigurimit fiduciar”

Trusti më kërkesën drejtuar AKK—së mendon se gjatë këtij aktiviteti pasi nuk ka pas ofertues tjerë mendon se ata kanë arritur marrëveshje të ndalur sipas ligjit të Konkurrencës ku Trusti dëmtohet sepse detyrohet të paguaj më shtrenjtë se sa kur kemi një tender në mënyra të rregullta konkurruese.

Gjatë shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës në mungesë komisionit nuk kemi pas mundësi që në atë kohë ta shqyrtojmë edhe pse ka pas elemente të dyshimit të një marrëveshjeje të ndaluar sipas ligjit te konkurrencës 03-L/229.

Pas të gjitha aktiviteteve që janë kryer dha ankesave që ka bërë “Trusti” në OSHP i njëjti organ ka anuluar këtë aktivitet prokurimi dhe për këtë lloj aktiviteti të prokurimit KRPP ka organizuar edhe tri shpallje tjera publike.

Nga dokumentet e shqyrtuara arrijmë në përfundim se aktiviteti i prokurimit për “Shërbimet e sigurimit fiduciar”, janë kontraktuar më kushtet e ekonomisë së tregut dhe se ky proces është kthyer në suaza të ligjit të konkurrencës dhe dyshimet për marrëveshje të fshehtë janë eliminuar.

Rasti si i tillë **pushon te shqyrtohet pasi që, pëlqimi apo miratimi është dhënë nga OSHP dhe është në favor të palës** në bazë të Ligjit Nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ky rast merr epilogun si ne dispozitiv të këtij

KONKLuzioni.

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të inicioj konfliktin administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative .

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- Arhiva

- Ankuesi “Fondi i Kursimeve Pensionale “ TRUSTI”, Prishtinë

KOMISIONI I AUTORITETI KOSOVAR TE KONKURRENCËS

(_____)

Valon Prestreshi
Kryetar

(_____)

Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar

(_____)

Fatime Haziri
Anëtare

(_____)

Muhamed Krasniqi
Anëtar

(_____)

Shaqir Morina
Anëtar